

Duke u nisur nga:

vendimi i qytetarëve të Malit të Zi që të jetojnë në shtetin e pavarur dhe sovran të Malit të Zi, të marrë në referendumin e 21 majit 2006;

deklarimi i qytetarëve të Malit të Zi që të jetojnë në shtetin në të cilin vlerat themelore janë liria, paqja, toleranca, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, multikulturalizmi, demokracia dhe sundimi i ligjit;

vendosmëria që si qytetarë të lirë dhe të barabartë, pjesëtarë të popujve dhe pakicave nacionale që jetojnë në Mal të Zi: malazezë, serbë, boshnjakë, shqiptarë, myslimanë, kroatë dhe të tjerë, jemi të përkushtuar Malit të Zi demokratik dhe qytetar;

bindja se shteti është përgjegjës për ruajtjen e natyrës, mjedisit jetësor të shëndetshëm, zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit të balancuar të të gjitha rajoneve të tij dhe vendosjes së të drejtës sociale;

besnikëria ndaj bashkëpunimit të barabartë me popujt dhe shtetet e tjera dhe integrimet evropiane dhe euro-atlantike;

Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në mbledhjen e tretë të seancës së dytë të rregullt në vitin 2007, me datën 19 tetor 2007 miraton

KUSHETUTËN E MALIT TË ZI

PJESA E PARË DISPOZITAT THEMELORE

Shteti

Neni 1

Mali i Zi është shtet i pavarur dhe sovran, me formë republikane të sundimit.
Mali i Zi është shtet qytetar, demokratik, ekologjik dhe shtet i së drejtës sociale, i bazuar në sundimin e ligjit.

Sovraniteti

Neni 2

Bartës i sovranitetit është qytetari që ka shtetësinë malazeze.
Qytetari e realizon pushtetin drejtpërdrejt dhe përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm.

Nuk mund të vendoset dhe as të pranohet pushteti që nuk del nga vullneti i lirë i shprehur i qytetarëve në zgjedhjet demokratike, në pajtim me ligjin.

Territori shtetëror

Neni 3

Territori i Malit të Zi është unitar dhe i patjetërsueshëm.

Simbolet shtetërore

Neni 4

Mali i Zi ka stemën, flamurin dhe himnin.
Stema e Malit të Zi është shqiponja e artë dykrenore me luanin në gjoks.
Flamuri i Malit të Zi është me ngjyrë të kuqe me stemë në mes dhe kornizë të artë.
Himni i Malit të Zi është “Oj svijetlla majska zoro” (“O agim i ndritshmi i majit”)

Qyteti i Fronit dhe kryeqyteti

Neni 5

Qyteti kryesor i Malit të Zi është Podgorica.
Qyteti i Fronit i Malit të Zi është Cetina.

Të drejtat dhe liritë e njeriut

Neni 6

Mali i Zi garanton dhe mbron të drejtat dhe liritë.
Të drejtat dhe liritë janë të pacenueshme.
Secili është i obliguar të respektojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Ndalimi i nxitjes së urrejtjes

Neni 7

Ndalohet provokimi ose nxitja e urrejtjes ose jotolerancës në çfarëdo baze.

Ndalimi i diskriminimit

Neni 8

Ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, në çfarëdo baze.

Nuk do të konsiderohen diskriminim dispozitat dhe futja e masave të veçanta të cilat janë të drejtuara në krijimin e kushteve për realizimin barazisë nacionale, gjinore dhe të përgjithshme dhe mbrojtjes së personave që janë sipas cilësdo bazë në pozitë të pabarabartë.

Masat e veçanta mund të zbatohen vetëm deri sa të mos arrihen qëllimet për të cilat janë ndërmarrë.

Rendi juridik

Neni 9

Kontratat ndërkombëtare të verifikuara dhe të publikuara dhe rregullat e pranuar në përgjithësi të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e rregullimit të brendshëm juridik, kanë përparësi mbi legjislacionin vendas dhe zbatohen drejtpërdrejt, kur raportet i rregullojnë ndryshe nga legjislacioni i brendshëm.

Kufijtë e lirive

Neni 10

Në Mal të Zi është e lirë gjithçka që nuk ndalohet me Kushtetutë dhe Ligj.

Çdokush është i obliguar t'i përmbahet Kushtetutës dhe ligjit.

Ndarja e pushtetit

Neni 11

Pushteti është i organizuar sipas parimit të ndarjes së pushtetit në: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Pushtetin legjislativ e kryen Kuvendi, pushtetin ekzekutiv e kryen Qeveria, kurse atë gjyqësor gjykatat.

Pushteti kufizohet me Kushtetutë dhe ligj.

Raporti i pushtetit bazohet në ekuilibrin dhe kontrollin e ndërsjellë.

Malin e Zi e përfaqëson Presidenti i Malit të Zi.

Kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e mbron gjykata Kushtetuese.

Ushtria dhe shërbimet e sigurisë janë nën kontrollin demokratik dhe civil.

Shtetësia malazeze

Neni 12

Në Mal të Zi ekziston shtetësia malazeze.

Mali i Zi mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve malazezë.

Shtetasi malazez nuk mund të jetë i dëbuar e as i ekstraduar në një shtet tjetër, përveç në pajtim me detyrimet ndërkombëtare të Malit të Zi.

Gjuha dhe alfabeti

Neni 13

Gjuha zyrtare në Mal të Zi është gjuha malazeze.

Alfabeti cirilik dhe alfabeti latin janë me të drejta të barabarta.

Në përdorim zyrtar janë edhe gjuha serbe, boshnjake, shqipe dhe kroate

Ndarja e bashkësive fetare nga shteti

Neni 14

Bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti.

Bashkësitë fetare janë të barabarta dhe të lira në kryerjen e ceremonive dhe punëve fetare.

Raporti me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare

Neni 15

Mali i Zi, sipas parimeve dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare, bashkëpunon dhe zhvillon marrëdhënie miqësore me shtetet e tjera, me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.

Mali i Zi mund të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare.

Kuvendi vendos për mënyrën e aderimit në Bashkimin Evropian.

Mali i Zi nuk mund të hyjë në bashkësi me një shtet tjetër me të cilin humb pavarësinë dhe sovranitetin e plotë ndërkombëtar.

Legjislacioni

Neni 16

Me ligj, në pajtim me Kushtetutën, rregullohen:

- 1) mënyra e realizimit të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, kur kjo është e domosdoshme për realizimin e tyre;
- 2) mënyra e realizimit të të drejtave të veçanta të pakicave;
- 3) mënyra e themelimit, organizimi dhe kompetencat e organeve të pushtetit dhe procedura para këtyre organeve, nëse kjo është e domosdoshme për funksionimin e tyre;
- 4) sistemi i vetëqeverisjes lokale;
- 5) çështje të tjera me interes për Malin e Zi.

PJESA E DYTË TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT

1. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Baza dhe barazia

Neni 17

Të drejtat dhe liritë realizohen në bazë të Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara.

Të gjithë janë të barabartë para ligjit, pavarësisht nga çdo dallim ose karakteristikë personale.

Barazia gjinore

Neni 18

Shteti garanton barazinë e gruas dhe të burrit dhe zhvillon politikën e mundësive të barabarta.

Mbrojtja

Neni 19

Çdokush ka të drejtë në mbrojtje të njëjtë të drejtave dhe lirive të veta.

Këshillimi juridik

Neni 20

Gjithkush ka të drejtën e këshillimit ligjor kundër vendimit me të cilën vendoset për të drejtën e tij ose për interesin e bazuar në ligj.

Ndihma juridike

Neni 21

Gjithkush ka drejtën e ndihmës juridike.

Të drejtën juridike e ofron avokatura, si profesion i pavarur dhe autonom, dhe shërbime të tjera.

Ndihma juridike mund të jetë falas, në pajtim me ligjin.

E drejta e vetëqeverisjes lokale

Neni 22

Garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale.

Mjedisi jetësor

Neni 23

Gjithkush ka të drejtën e mjedisit jetësor të shëndetshëm.

Gjithkush ka të drejtë të njoftohet në kohën e duhur dhe plotësisht mbi gjendjen e mjedisit jetësor, për mundësinë e ndikimit me rastin e vendosjes për çështjet me rëndësi për mjedisin jetësor dhe në mbrojtjen juridike të këtyre të drejtave.

Gjithkush, e veçanërisht shteti, është i obliguar të ruajë dhe të përparojë mjedisin jetësor.

Kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut

Neni 24

Të drejtat dhe liritë e njeriut mund të kufizohen vetëm me ligj, aq sa e lejon Kushtetuta dhe në masën që është e domosdoshme me qëllim që në shoqërinë e hapur dhe të lirë demokratike të plotësohet qëllimi për të cilin është lejuar kufizimi.

Kufizimet nuk mund të futen për qëllime të tjera përveç atyre për hir të të cilave janë paraparë.

Kufizimi i përkohshëm i të drejtave dhe lirive

Neni 25

Gjatë kohës së shpalljes së gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme mund të kufizohet realizimi i të drejtave dhe lirive të veçanta të njeriut, me sasinë në të cilën kjo është e domosdoshme.

Kufizimi nuk guxohet të bëhet në bazë të seksit, nacionalitetit, racës, besimit, gjuhës, prejardhjes etnike ose shoqërore, bindjes politike ose çfarëdo bindjeje tjetër, gjendjes materiale ose cilësdo karakteristikë tjetër personale.

Nuk mund të kufizohet e drejta për: jetën; këshillimin juridik dhe ndihmën juridike; dinjitetin dhe respektimin e personalitetit; procesin gjyqësor të drejtë, publik dhe parimor legal; premisën e pafajësisë; mbrojtjen; dëmshpërblimin për heqjen e lirisë në

mënyrë të paligjshme ose të pa bazë dhe dënimit të pa bazë; lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; lidhjen martesore.

Nuk mund të hiqen ndalesat: e shkaktimit dhe të nxitjes së urrejtjes ose jo tolerancës; diskriminimit; rigjykimit dhe gjykimit për të njëjtën vepër penale; asimilimit të dhunshëm.

Masat e kufizimit mund të jenë në fuqi derisa të zgjasë gjendja e luftës ose gjendja e jashtëzakonshme.

2. TË DREJTAT DHE LIRITË PERSONALE

Ndalimi i dënimit me vdekje

Neni 26

Në Malin e Zi është i ndaluar dënimi me vdekje.

Biomedicina

Neni 27

Garantohet e drejta e njeriut dhe dinjiteti i qenies njerëzore në drejtim të zbatimit të biologjisë dhe të mjekësisë.

Ndalohet çdo intervenim i drejtuar në krijimin e qenies njerëzore e cila është gjenetikiisht identike me qenien njerëzore, të gjallë ose të vdekur.

Ndalohet që në qenien njerëzore, pa pëlqimin e tij, të kryhen eksperimente mjekësore dhe të tjera.

Dinjiteti dhe paprekshmëria e personalitetit

Neni 28

Garantohet dinjiteti dhe siguria e njeriut.

Garantohet paprekshmëria e integritetit fizik dhe psikik të njeriut, privatësisë së tij dhe të drejtave personale.

Askush nuk guxon t'i nënshtrohet torturës ose sjelljes jonjerëzore ose poshtëruese.

Askush nuk guxon të mbahet në robëri ose gjendje robërie.

Heqja e lirisë

Neni 29

Secili ka të drejtë në lirinë personale.

Heqja e lirisë është e lejuar vetëm për shkakun dhe në procedurën që është paraparë me ligj.

Personi, të cilit i është hequr liria, duhet menjëherë të njoftohet në gjuhën e vet ose në gjuhën që e kupton për shkaqet e heqjes së lirisë.

Personi, të cilit i është hequr liria, në të njëjtën kohë duhet të njoftohet se nuk është i obliguar të deklaroj asgjë.

Me kërkesë të personit, të cilit i është hequr liria, organi është i obliguar që për heqjen e lirisë të njoftojë menjëherë personin, të cilin e cakton personi të cilit i është hequr liria.

Personi, të cilit i është hequr liria, ka të drejtë që gjatë deklarimit të tij të jetë i pranishëm mbrojtësi që ka zgjedhur.

Heqja e lirisë në mënyrë të paligjshme është e dënueshme.

Arresti Neni 30

Personi për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer një veprë penale mundet, në bazë të vendimit të gjykatës kompetente, të arrestohet dhe të mbahet në paraburgim vetëm, nëse kjo është e domosdoshme për përcjelljen e procedurës penale.

Personit të arrestuar duhet t'i dorëzohet vendimi i arsyetuar në momentin e arrestimit ose më së largu në afatin prej 24 orësh nga arrestimi.

Kundër vendimit për paraburgim personi i arrestuar ka të drejtë ankese, për të cilën gjykata vendos në afatin prej 48 orësh.

Kohëzgjatja e paraburgimit duhet të bihet në afatin kohor më të shkurtër të mundshëm.

Paraburgimi mund të zgjasë sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë jo më gjatë se tre muaj nga dita e paraburgimit, ndërsa me vendimin e gjykatës së lartë, mund të zgjatet edhe tre muaj.

Nëse deri në kalimin e këtyre afateve nuk ngrihet padia, i pandehuri lëshohet në liri.

Paraburgimi i personit të mitur nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë.

Respektimi i personalitetit Neni 31

Garantohet respektimi i personalitetit dhe i dinjitetit njerëzor në procesin penal ose në ndonjë proces tjetër, në rastin e heqjes ose kufizimit të lirisë dhe gjatë kohës së kryerjes të dënimit.

Ndalohet dhe dënohet çdo dhunë, sjellje jonjerëzore ose poshtëruese ndaj personit të cilit i është hequr liria ose i është kufizuar liria, si dhe shantazhi i pranimit dhe i deklaratës.

Gjykimi i drejtë dhe publik Neni 32

Secili ka të drejtë në proces gjyqësor të drejtë dhe publik në afatin kohor të kuptueshëm para gjykatës së pavarur, të paanshme dhe të themeluar me ligj.

Parimi i ligjshmëris Neni 33

Askush nuk mund të ndëshkohet për veprën që, para se është kryer, nuk ka qenë e paraparë me ligj si veprë e ndëshkueshme, e as që mund t'i jepet dënimi që për këtë veprë nuk ka qenë i paraparë.

Ligji më i butë Neni 34

Veprat penale dhe veprat e tjera të dënueshme vërtetohen dhe dënimet për to shprehen sipas ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së këtyre veprave, përveç nëse ligji i ri është më i butë për kryerësin.

Supozimi i pafajësisë Neni 35

Secili konsiderohet i pafajshëm përderisa të mos përcaktohet fajësia me vendim të plotfuqishëm të gjykatës.

I pandehuri nuk është i obliguar të dëshmojë pafajësinë e vet.

Dyshimin në drejtim të vështimit të fajësisë gjykata është e obliguar ta komentojë në interes të të pandehurit.

Ne bis in idem

Neni 36

Askush nuk mund të rigjykohej e as të dënohet përsëri për të njëjtën veprë të dënueshme.

E drejta e mbrojtjes

Neni 37

Secilit i garantohet e drejta e mbrojtjes, e veçanërisht: që të jetë i njoftuar në gjuhën që e kupton për akuzën kundër vetes; që të ketë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe që të mbrohet personalisht ose përmes mbrojtësit që e zgjedh vetë.

Dëmshpërblimi për shkak të veprimit të paligjshëm

Neni 38

Personi, të cilit në mënyrë të paligjshme ose të pa bazuar i është hequr liria ose është dënuar pa bazë, ka të drejtën e dëmshpërblimit nga shteti.

Lëvizja dhe vendbanimi

Neni 39

Garantohet e drejta e lirisë së lëvizjes dhe të vendbanimit, si dhe e drejta e largimit nga Mali i Zi.

Lëvizja e lirë, vendbanimi dhe largimi nga Mali i Zi mund të kufizohet nëse kjo është e nevojshme gjatë përcjelljes së procesit penal, parandalimit të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe për shkak të sigurisë së Malit të Zi.

Lëvizja dhe qëndrimi i personave të huaj përcaktohet me ligj.

E drejta e privatësisë

Neni 40

Secili ka të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare.

Pacenueshmëria e banesës

Neni 41

Banesa është e pacenueshme.

Askush nuk mundet pa vendimin e gjykatës të hyjë në banesë ose në lokale të tjera kundër vullnetit të mbajtësit të tyre dhe në to të kryejë bastisje.

Bastisja kryhet në praninë e dy dëshmitarëve.

Personi zyrtar mund të hyjë në banesën e huaj ose në lokale të tjera edhe pa vendimin e gjykatës dhe të kryejë bastisjen pa praninë e dëshmitarëve, nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të parandalimit të kryerjes së veprës penale, kapjes së drejtpërdrejtë të kryerësit të veprës penale ose për të shpëtuar njerëzit dhe pasurinë.

Fshehtësia e letrave

Neni 42

Fshehtësia e letrave, bisedave telefonike dhe mjeteve të tjera të komunikimit është e pacenueshme.

Nga parimi i pacenueshmërisë së fshehtësisë së letrave, bisedave telefonike dhe mjeteve të tjera të komunikimit mund të anashkalohej vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, nëse kjo është e domosdoshme për përcjelljen e procesit penal ose për shkak të sigurisë së Malit të Zi.

Të dhënat për personalitetin

Neni 43

Garantohet e drejta e mbrojtjes së të dhënave mbi personalitetin
Ndalohej përdorimi i të dhënave për personalitetin jashtë qëllimit për të cilin janë grumbulluar.

Gjithkush ka të drejtë të jetë i njoftuar me të dhënat që janë grumbulluar për personalitetin e tij dhe ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të keqpërdorimit.

E drejta për azil

Neni 44

Personi i huaj që frikësohet me arsye nga persekutimi për shkak të racës së vet, gjuhës, besimit ose përkatësisë ndonjë kombësie ose grupi ose për shkak të bindjeve politike, mund të kërkojë azil në Mal të Zi.

Personi i huaj nuk mund të dëbohet nga Mali i Zi atje, ku për shkak të racës, besimit, gjuhës ose përkatësisë nacionale, i kërcënohet dënimi me vdekje, torturimi, sjellja jonjerëzore, persekutimi ose shkelja serioze e të drejtave të cilat i garanton kjo Kushtetutë.

Personi i huaj mund të dëbohet nga Mali i Zi vetëm në bazë të vendimit të organit kompetent dhe në procedurën e përcaktuar me ligj.

3. TË DREJTAT DHE LIRITË POLITIKE

E drejta e votës

Neni 45

Të drejtën që të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur e ka shtetasi i Malit të Zi, që i ka mbushur 18 vjet dhe ka më së paku dy vjet vendbanimin në Mal të Zi.

E drejta e votës realizohet në zgjedhje.

E drejta e votës është e përgjithshme dhe e barabartë.

Zgjedhjet janë të lira dhe të drejtpërdrejta, kurse votimi është i fshehtë.

Liria e të menduarit, e ndërgjegjes dhe e besimit

Neni 46

Secilit i garantohet e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, si dhe e drejta që të ndryshojë besimin ose bindjen dhe lirinë që, vetë ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht, të shfaqë besimin ose bindjen me lutje, predikime, zakone ose ceremoni.

Askush nuk është i obliguar që të deklarohet për bindjet e veta fetare ose të tjera.

Liria e manifestimit të bindjeve fetare mund të kufizohet vetëm nëse kjo është e domosdoshme për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve, rendit dhe paqes publike, si dhe të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë.

Liria e të shprehurit

Neni 47

Secili ka të drejtën e lirisë së të shprehurit me të folur, me fjalë të shkruar, me fotografi ose në mënyrë tjetër.

E drejta për lirinë e të shprehurit mund të kufizohet vetëm me të drejtën e tjetrit për dinjitetin, reputacionin dhe nderin dhe nëse kërcënohet morali publik dhe siguria e Malit të Zi.

Kundërshtimi i ndërgjegjes

Neni 48

Kushdo ka të drejtë në kundërshtim të ndërgjegjes.

Askush nuk është i obliguar që në kundërshtim me besimin ose bindjet e veta të plotësojë detyrimin ushtarak ose ndonjë tjetër që përfshin përdorimin e armëve.

Liria e shtypit

Neni 49

Garantohet liria e shtypit dhe e formave të tjera të njoftimeve publike.

Garantohet e drejta që, pa miratim, të themelohen gazeta dhe mjete të tjera të informimit publik, krahas regjistrimit të organi kompetent.

Garantohet e drejta për përgjigje dhe e drejta në përmirësimin e informacionit të gënjeshtërt, jo të plotë ose të pasaktë të transmetuar, me të cilin është shkelur e drejta e dikujt ose interesi dhe e drejta në shpërblimin e dëmit të shkaktuar me publikimin e të dhënave ose njoftimeve të pasakta.

Ndalimi i censurës

Neni 50

Në Mal të Zi nuk ka censurë.

Gjykata kompetente mund të parandalojë përhapjen e informacioneve dhe ideve përmes mjeteve të informimit publik, vetëm nëse kjo është e domosdoshme për: parandalimin e thirrjes për shkatërrimin e dhunshëm të sistemit ligjor të përcaktuar me Kushtetutë; ruajtjen e integritetit territorial të Malit të Zi; parandalimin e propagandimit të luftës ose nxitjes së dhunës ose kryerjes së veprës penale; parandalimin e propagandimit të urrejtjes racore, nacionale dhe fetare ose të diskriminimit.

Qasja në informacione

Neni 51

Kushdo ka të drejtë të ketë qasje në informacionet që ka në posedim organi shtetëror dhe organizatat që kryejnë punë me kompetenca publike.

E drejta e qasjes në informacione mund të kufizohet nëse kjo është në interes: të mbrojtjes së jetës; të shëndetit publik, moralit dhe privatësisë; të përcjelljes së procesit penal; sigurisë dhe mbrojtjes së Malit të Zi; politikës së jashtme, monetare dhe ekonomike.

Liria e tubimit

Neni 52

Garantohet liria e tubimit paqësor, pa leje, me lajmërim paraprak tek organi kompetent.

Liria e tubimit mund të kufizohet përkohësisht me vendimin e organit kompetent për të parandaluar trazirat ose kryerjen e veprave penale, rrezikimin e shëndetit, moralit ose për shkak të sigurisë së njerëzve dhe pasurisë, në pajtim me ligjin.

Liria e bashkimit në shoqata

Neni 53

Garantohet liria e bashkimit politik, sindikalist dhe çdo bashkim e veprimtari tjetër, pa leje, me regjistrim tek organi kompetent.

Askush nuk mund të detyrohet të jetë anëtar i ndonjë shoqate.

Shteti ndihmon shoqatat politike dhe shoqatat e tjera, kur ekziston interesi publik.

Ndalimi i organizimit

Neni 54

Ndalohet organizimi politik në organet shtetërore.

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari, Prokurori shtetëror dhe zëvendësi i tij, Mbrojtësi i të drejtave dhe lirive të njeriut, anëtari i Këshillit të Bankës Qendrore, anëtari i Senatit Shtetëror të institucionit të Revizionit, pjesëtari profesionist i Ushtrisë, Policisë dhe shërbimeve të tjera të sigurisë nuk mund të jetë anëtar i organizatës politike.

Ndalohet organizimi dhe veprimtaria politike e të huajve dhe organizatave politike të cilat e kanë selinë e vet jashtë Malit të Zi.

Ndalimi i veprimtarisë dhe i themelimit

Neni 55

Ndalohet veprimtaria e organizatave politike dhe e organizatave të tjera që kanë për qëllim shkatërrimin e dhunshëm të rendit kushtetues, shkeljen e tërësisë së përgjithshme territoriale të Malit të Zi, shkeljen e lirive dhe të drejtave të garantuara ose nxitjen e urrejtjes dhe të jo tolerancës racore, fetare dhe të tjera.

STAV 2 FALI

E drejta e referimit organizatave ndërkombëtare

Neni 56

Secili ka të drejtë t'u drejtohet organizatave ndërkombëtare me qëllim që të mbrojtë të drejtat dhe liritë e veta të garantuara me Kushtetutë.

E drejta e referimit

Neni 57

Secili ka të drejtë që, individualisht ose së bashku me personat e tjerë, t'i referohet organit shtetëror ose organizatës që kryen kompetenca publike dhe të marrë përgjigje.

Askush nuk mund të ketë përgjegjësi, ose të durojë pasoja të tjera të dëmshme për shkak të qëndrimeve të shprehura gjatë referimit, përveç nëse me këtë ka bërë vepër penale.

4. TË DREJTAT DHE LIRITË EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

Prona

Neni 58

Garantohet e drejta e pronës.

Askujt nuk mund t'i privohet ose t'i kufizohet e drejta e pronës, përveç nëse këtë e kërkon interesi publik, krahas dëmshpërblimit adekuat.

Pasuritë natyrore dhe të mirat në përdorim të përgjithshëm janë në pronësi shtetërore.

Sipërmarrja

Neni 59

Garantohet liria e sipërmarrjes.

Liria e sipërmarrjes mund të kufizohet vetëm nëse kjo është e domosdoshme për shkak të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, mjedisit jetësor, resurseve natyrore, trashëgimisë kulturore ose sigurisë dhe mbrojtjes së Malit të Zi.

E drejta e trashëgimisë

Neni 60

E drejta e trashëgimisë është e garantuar.

Të drejtat e të huajve

Neni 61

Personi i huaj mund të jetë subjekt i të drejtës së trashëgimisë në pajtim me ligjin.

E drejta për punë

Neni 62

Secili ka të drejtën e punës, zgjedhjen e lirë të profesionit dhe të punësimit, në kushte të drejta dhe humane të punës dhe në të siguarit gjatës kohës së papunësisë.

Ndalimi i punës së detyruar

Neni 63

Puna e detyruar është e ndaluar.

Me punë të detyruar nuk konsiderohet: puna e zakonshme në kuadër të vuajtjes së dënimit të heqjes së lirisë; kryerja e shërbimit të natyrës ushtarake dhe shërbimit që kërkohet në vend të saj; puna që kërkohet në rast krize ose fatkeqësie e cila kërcënon jetën e njerëzve ose pasurinë.

Të drejtat e të punësuarve

Neni 64

Të punësuarit kanë të drejtën e pagës përkatëse.

Të punësuarit kanë të drejtën e kufizimit të orarit të punës dhe të pushimit të paguar.

Të punësuarit kanë të drejtën për të qenë të siguar në punë.

Rinia, gratë dhe invalidët gëzojnë mbrojtje të veçantë në punë.

Këshilli social

Neni 65

Pozita sociale e të punësuarve harmonizohet në Këshillin Social.

Këshillin social e përbëjnë përfaqësuesit e sindikatave, punëdhënësve dhe të Qeverisë.

**Greva
Neni 66**

Të punësuarit kanë të drejtë në grevë.

E drejta e grevës mund t'u kufizohet të punësuarve në ushtri, polici, organe shtetërore dhe shërbime publike me qëllim që të mbrohet interesi publik, në pajtim me ligjin.

**Sigurimi social
Neni 67**

Sigurimi social i të punësuarve është i obliguar.

Shteti siguron siguri materiale personit që nuk është i aftë për punë dhe nuk ka mjete për jetesë.

**Mbrojtja e personave me invaliditet
Neni 68**

Garantohet mbrojtja e veçantë personave me invaliditet.

**Mbrojtja shëndetësore
Neni 69**

Secili ka të drejtën e sigurimit shëndetësor.

Fëmija, shtatzëna, personi i moshuar dhe personat me invaliditet kanë të drejtën e mbrojtjes shëndetësore nga të ardhurat publike, nëse këtë të drejtë nuk e realizon mbi ndonjë bazë tjetër.

**Mbrojtja e konsumatorëve
Neni 70**

Shteti mbron konsumatorin.

Janë të ndaluara veprimet me të cilat dëmtohet shëndeti, siguria dhe privatësia e konsumatorit.

**Martesa
Neni 71**

Martesa mund të lidhet vetëm me pranimin e lirë të femrës dhe mashkullit.

Martesa bazohet në barazinë e bashkëshortëve.

**Familja
Neni 72**

Familja gëzon mbrojtje të veçantë.

Prindërit janë të obliguar të kujdesen për fëmijët, t'i edukojnë dhe t'i shkollojnë.

Fëmijët janë të obliguar të kujdesen për prindërit e vet të cilëve u nevojitet ndihmë.

Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta dhe obligime të barabarta si edhe fëmijët e lindur në martesë.

**Mbrojtja e nënës dhe e fëmijës
Neni 73**

Nëna dhe fëmija gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Shteti krijon kushtet me të cilat nxitet lindja e fëmijëve.

Të drejtat e fëmijës

Neni 74

Fëmija gëzon të drejtat dhe liritë e përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e tij.
Fëmijës i garantohet mbrojtja e veçantë nga shfrytëzimi psikik, fizik, ekonomik dhe çdo shfrytëzim ose keqpërdorim tjetër.

Arsimimi

Neni 75

Garantohet e drejta e arsimimit në kushte të barabarta.
Arsimi fillor është i detyrueshëm dhe falas.
Garantohet autonomia e universitetit, institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve shkencore.

E drejta e krijimtarisë

Neni 76

Garantohet liria e krijimtarisë shkencore, kulturore dhe artistike.
Garantohet liria e publikimit të veprave shkencore dhe artistike, zbulimeve shkencore dhe shpikjeve teknike, kurse krijuesve të tyre të drejtat morale dhe të pronësisë.

Shkenca, kultura dhe arti

Neni 77

Shteti nxit dhe ndihmon zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, artit, sportit kulturës fizike dhe teknike.
Shteti mbron vlerat shkencore, kulturore, artistike dhe historike.

Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Neni 78

Gjithkush është i obliguar të ruajë trashëgiminë natyrore dhe kulturore me interes të përgjithshëm.
Shteti mbron trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

5. TË DRETAT E VEÇANTA TË PAKICAVE

Mbrojtja e identitetit

Neni 79

Pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale u garantohen të drejtat dhe liritë, të cilat mund të përdoren individualisht dhe në bashkësi me të tjerët:

- 1) në shprehjen, ruajtjen, zhvillimin dhe manifestimin publik të veçantisë nacionale, etnike, kulturore dhe fetare;
- 2) në zgjedhjen, përdorimin dhe të shfaqurit publikisht të simboleve kombëtare dhe krentrimin e festave kombëtare;
- 3) në përdorimin e gjuhës dhe të alfabetit të vet në përdorim privat, publik dhe zyrtar;

- 4) në arsimimin në gjuhën dhe alfabetin e vet në institucionet shtetërore dhe që programet mësimore të përfshijnë edhe historinë dhe kulturën e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave;
- 5) që në mjediset me pjesëmarrje të konsiderueshme në popullatë organet e vetëqeverisjes lokale, organet shtetërore dhe gjyqësore të udhëheqin procesin edhe në gjuhën e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave;
- 6) që të formojnë shoqatat arsimore, kulturore dhe fetare me ndihmën materiale të shtetit;
- 7) që emrin dhe mbiemrin e vet ta regjistrojnë dhe ta përdorin në gjuhën dhe alfabetin e vet në dokumentet zyrtare;
- 8) që në mjediset me pjesëmarrje të konsiderueshme në popullatë emërimet tradicionale lokale, emrat e rrugëve dhe të lagjeve, si dhe shenjat topografike të jenë të shkruara edhe në gjuhën e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave;
- 9) në përfaqësimin autentik në Kuvendin e Malit të Zi dhe kuvendet e njësive të vetëqeverisjes lokale në të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës, sipas parimit të aksionit afirmativ;
- 10) në përfaqësimin proporcional në shërbimet publike, organet e pushtetit shtetëror dhe vetëqeverisjes lokale;
- 11) në informimin në gjuhën e vet;
- 12) që të vendosin dhe mbajnë kontakte me qytetarët dhe shoqatat jashtë Malit të Zi me të cilat kanë prejardhje të përbashkët nacionale dhe etnike, trashëgimi kulturore-historike, si dhe bindje fetare;
- 13) në formimin e këshillit për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të veçanta.

Ndalimi i asimilimit

Neni 80

Është i ndaluar asimilimi i dhunshëm i pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave.

Shteti është i obliguar të mbrojë pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nga të gjitha format e asimilimit të dhunshëm.

6. MBROJTËSI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT

Neni 81

Mbrojtësi i të Drejtave dhe i Lirive të Njeriut në Malin e Zi është organ sovran dhe i pavarur që ndërmerr masat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut kryen funksionin në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe kontratave ndërkombëtare të ratifikuara, duke u përmbajtur parimit të drejtësisë dhe të paanësisë.

Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut emërohet në kohën prej gjashtë vjetësh dhe mund të shkarkohet në rastet e parapara me ligj.

PJESA E TRETË RREGULLIMI I PUSHTETIT

1. KUVENDI I MALIT TË ZI

Kompetencat Neni 82

Kuvendi:

- 1) miraton Kushtetutën;
- 2) miraton Ligjet;
- 3) miraton dispozitat e tjera dhe aktet e përgjithshme (vendimet, përfundimet, rezolutat, deklaratat dhe rekomandimet);
- 4) shpall gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme;
- 5) miraton Buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;
- 6) miraton Strategjinë Sigurisë Nacionale dhe Strategjinë e Mbrojtjes;
- 7) miraton Planin e Zhvillimit dhe Planin hapësinor të Malit të Zi;
- 8) vendos për përdorimin e njësive të Ushtrisë së Malit të Zi në forcat ndërkombëtare;
- 9) rregullon sistemin e administratës shtetërore;
- 10) kryen kontrollin e Ushtrisë dhe të shërbimeve të sigurisë;
- 11) shpall referendumin shtetëror;
- 12) zgjedh dhe shkarkon Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë;
- 13) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme, Kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- 14) emëron dhe shkarkon: Prokurorin e lartë shtetëror dhe prokurorët shtetërorë, Mbrojtësin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Guvernatorin e Bankës Qendrore dhe anëtarët e Këshillit të Bankës Qendrore të Malit të Zi; kryetarin dhe anëtarët e Senatit të Institucionit Shtetëror të revizionit dhe bartësit e funksioneve të tjera të përcaktuara me ligj;
- 15) vendos mbi të drejtat e imunitetit;
- 16) jep amnistinë;
- 17) ratifikon kontratat ndërkombëtare;
- 18) shpall kreditë publike dhe vendos për huamarrjen e Malit të Zi;
- 19) vendos për tjetërsimin e pasurisë shtetërore mbi vlerën e përcaktuar me ligj;
- 20) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë ose ligj.

Përbërja e Kuvendit Neni 83

Kuvendin e përbëjnë deputetët që zgjidhen drejtpërdrejt, në bazë të së drejtës së përgjithshme dhe të barabartë dhe me votim të fshehtë.

Kuvendi ka 81 deputetë.

Mandati i Kuvendit Neni 84

Mandati i Kuvendit zgjat 4 vjet.

Kuvendit mund t'i pushojë mandati para afatit për të cilin është zgjedhur me shpërbërje ose me shkurtrim të mandatit të Kuvendit.

Nëse mandati i Kuvendit kalon në kohën e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, mandati zgjatet më së shumti 90 ditë pas pushimit të rrethanave që e kanë shkaktuar këtë gjendje.

STAV 4 FALI

Të drejtat dhe obligimet e deputetit

Neni 85

Deputeti përcaktohet dhe voton sipas bindjes së vet.
Deputeti ka të drejtë që funksionin e deputetit ta kryejë profesionalisht.

Imuniteti

Neni 86

Deputeti gëzon imunitet.

Deputeti nuk mund të merret në përgjegjësi penale ose një përgjegjësi tjetër si dhe të arrestohet për shkak të mendimit të shprehur ose votimit gjatë kryerjes së funksionit të tij si deputet.

Kundër deputetit nuk mund ngrihet procedurë penale dhe as të përcaktohet paraburgimi, pa lejen e Kuvendit, përveç nëse është zënë në kryerjen e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi me kohëzgjatje më të madhe se pesë vjet burgim.

Imunitetin, si dhe deputetët, e gëzojnë: Presidenti i Malit të Zi, Kryeministri dhe anëtarët e Qeverisë, Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryetari dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Prokurori i lartë shtetëror.

Pushimi i mandatit të deputetit

Neni 87

Deputetit i pushon mandati para kalimit të kohës për të cilën është zgjedhur:

- 1) kur jep dorëheqje;
- 2) nëse me vendimin e plotfuqishëm të gjykatës dënohet me dënim të pakusht të burgimit në kohëzgjatje më së paku gjashtë muaj;
- 3) nëse me vendimin e plotfuqishëm i është privuar aftësia e punës;
- 4) me ndërprerjen e shtetësisë malazeze.

Konstituimi i kuvendit

Neni 88

Seancën e parë të përbërjes së porsazgjedhur të Kuvendit e fton kryetari i Kuvendit i përbërjes së mëparshme dhe mbahet jo më larg se 15 ditë nga dita e publikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Kryetari dhe nënkryetari i Kuvendit

Neni 89

Kuvendi ka Kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë, të cilët i zgjedh nga përbërja e vet në kohën prej katër vjetësh.

Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, thërret Kuvendin në seanca dhe i kryeson. Kujdeset për zbatimin e rregullores së Kuvendit, shpall zgjedhjet për President të Malit të Zi dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe rregullore të Kuvendit.

STAV 3 FALI

Seancat e Kuvendit

Neni 90

Kuvendi punon ne seanca të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Seanca e rregullt mbahet dy herë në vjet.

Seanca e parë e rregullt fillon ditën e parë të punës në mars dhe zgjat deri në fund të korrikut, kurse seanca e dytë ditën e parë të punës në tetor dhe zgjat deri në fund të dhjetorit.

Seanca e jashtëzakonshme thirret me kërkesë të Kryetarit të Malit të Zi, Qeverisë ose më së paku një të tretës të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Marrja e vendimeve

Neni 91

Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve që janë prezent në seancë në të cilën marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve, nëse me Kushtetutë nuk është rregulluar ndryshe.

Me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, Kuvendi miraton ligjet me të cilat rregullohen: mënyra e realizimit të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, shtetësia malazeze, referendumi, detyrimet materiale të qytetarëve, simbolet shtetërore dhe përdorimi e shfrytëzimi i simboleve shtetërore, mbrojtja dhe siguria, ushtria, themelimi, bashkimi dhe shuarja e komunave; shpallë gjendje lufte dhe gjendje të jashtëzakonshme; miraton planin hapësinor; miraton rregulloren e punës së Kuvendit; vendos për shpalljen e referendumit shtetëror; vendos për shkurtimin e mandatit; vendos për shkarkimin e presidentit të Republikës; zgjedh dhe shkarkon kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë dhe vendos për besimin e Qeverisë; zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Gjykatës Supreme, kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetues; emëron dhe shkarkon Mbrojtësin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kuvendi vendos me shumicën prej 2/3 e votave e të gjithë deputetëve për ligjet me të cilat rregullohet sistemi zgjedhor dhe të drejtat pronësore të të huajve.

Në votimin e parë me 2/3 e shumicës dhe në votimin e dytë me shumicën e të gjithë deputetëve më së afërmi pas tre muajsh, Kuvendi vendos për ligjet me të cilat rregullohet mënyra e realizimit të të drejtave të arritura të pakicave dhe përdorimi i njësisive të ushtrisë në forcat ndërkombëtare.

Shpërndarja e Kuvendit

Neni 92

Kuvendi shpërndahet nëse nuk e zgjedh Qeverinë në afatin prej 90 ditësh nga dita kurpresidenti i Malit të Zi herën e parë propozon mandatarin.

Nëse Kuvendi për një kohë të gjatë nuk i ushtron kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë, Qeveria, pasi dëgjon mendimin e Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të klubeve të deputetëve në Kuvend, mund ta shpërndajë Kuvendin.

Kuvendi shpërndahet me dekretin e presidentit të Malit të Zi.

Kuvendi nuk mund të shpërndahet në kohën e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, nëse është iniciuar procesi i votimit të mosbesimit ndaj Qeverisë, si dhe tre muajt e parë nga konstituimi dhe tre muajt para përfundimit të mandatit.

Presidenti i Malit të Zi shpall zgjedhjet ditën e parë në vijim nga dita e shpërndarjes së Kuvendit.

Propozimi i ligjit dhe i akteve të tjera

Neni 93

Të drejtën e propozimit të ligjit dhe të akteve të tjera e kanë Qeveria dhe deputeti.

Të drejtën e propozimit të ligjit e kanë edhe gjashtë mijë votues, përmes deputetit që e autorizojnë.

Propozimin për shpalljen e referendumit shtetëror mund ta paraqesin: më së paku 25 deputetë, Presidenti i Malit të Zi, Qeveria ose më së paku 10% e qytetarëve që kanë të drejtë vote.

Shpallja e ligjit

Neni 94

Presidenti i Malit të Zi është i detyruar të shpall ligjin në afatin prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të ligjit, gjegjësisht në afatin prej tri ditësh, nëse ligji është miratuar sipas procedurës urgjente ose t'ia kthejë ligjin Kuvendit që të vendosë përsëri.

Presidenti i Malit të Zi është i detyruar të shpallë përsëri ligjin e aprovuar.

2. PRESIDENTI I MALIT TË ZI

Kompetencat

Neni 95

Presidenti i Malit të Zi:

- 1) përfaqëson Malin e Zi brenda dhe jashtë vendit;
- 2) komandon Ushtrinë në bazë të vendimeve të Këshillit të Mbrojtjes dhe Sigurisë;
- 3) shpall ligjet me dekret;
- 4) shpall zgjedhjet për Kuvendin;
- 5) i propozon Kuvendit: mandatarin për formimin e Qeverisë, pas bisedimeve të zhvilluara me përfaqësuesit e partive politike të përfaqësuara në Kuvend; kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Mbrojtësin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;
- 6) emëron dhe shkarkon ambasadorët dhe shefat e përfaqësive të tjera të jashtme diplomatike të Malit të Zi, me propozim të Qeverisë dhe mendim të Këshillit të Kuvendit, i cili është kompetent për marrëdhëniet ndërkombëtare;
- 7) pranon letrat e akreditimit dhe letrat e shkarkimit të përfaqësuesve të jashtëm diplomatikë;
- 8) ndan dekoratat dhe mirënjohjet e Malit të Zi;
- 9) jep amnisti;
- 10) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë ose ligj.

Zgjedhja

Neni 96

Presidenti i Malit të Zi zgjidhet në bazë të së drejtës zgjedhore të përgjithshme barabartë, me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.

Presidenti i Malit të Zi mund të zgjidhet çdo shtetas malazez që ka vendbanimin në Mal të Zi së paku dhjetë vjet në pesëmbëdhjetë vitet e fundit.

Zgjedhjet për presidentin e Malit të Zi i shpall Kryetari i Kuvendit.

Mandati

Neni 97

Presidenti i Malit të Zi zgjidhet për pesë vjet.

I njëjti person mund të jetë president i Malit të Zi më së shumti dy herë.

Presidenti i Malit të Zi hyn në detyrë ditën e dhënies së betimit para deputetëve në Kuvend.

Nëse mandati i Presidentit kalon gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, mandati shtyhet më së shumti 90 ditë pas kalimit të rrethanave që kanë shkaktuar këtë gjendje.

Presidenti i Malit të Zi nuk mund të kryejë një funksion tjetër publik.

Pushimi i mandatit

Neni 98

Mandati i Presidenti të Malit të Zi pushon me skadimin e kohës për të cilën është zgjedhur, me dorëheqje, nëse është i parandaluar përgjithmonë që të kryejë detyrën e presidentit dhe me shkarkim.

Presidenti përgjigjet për shkelje të Kushtetutës.

Procedurën për përcaktimin se a e ka shkelur Kushtetutën Presidenti i Malit të Zi mund ta nisë Kuvendi, me propozimin e më së paku 25 deputetëve.

Propozimin për fillimin e procedurës Kuvendi ia dorëzon për t'u deklaruar Presidentit të Malit të Zi.

Vendimin për ekzistencën ose jo të shkeljes së Kushtetutës e miraton Gjykata Kushtetuese dhe pa vonesë e boton dhe ia dorëzon Kuvendit dhe Presidentit të Malit të Zi.

Kuvendi mund ta shkarkojë Presidentin e Malit të Zi, kur Gjykata Kushtetuese e vërteton se ka shkelur Kushtetutën.

Ushtrimi i funksionit në rastin e ndalimit ose pushimit të mandatit

Neni 99

Në rastin e pushimit të mandatit të Presidentit të Mali të Zi, deri në zgjedhjen e Presidentit të ri, si dhe në rastin e parandalimit të përkohshëm të Presidentit që të kryejë funksionin, këtë funksion e kryen Kryetari i Kuvendit.

3. QEVERIA E MALIT TË ZI

Kompetencat

Neni 100

Qeveria:

- 1) udhëheq politikën e brendshme dhe të jashtme të Malit të Zi;
- 2) ekzekuton ligjet, dispozitat e tjera dhe aktet e përgjithshme;
- 3) nxjerr dekretet, vendimet dhe aktet e tjera për ekzekutimin e ligjit;
- 4) nënshkruan kontratat ndërkombëtare;
- 5) propozon planin e zhvillimit dhe planin hapësinor të Malit të Zi;
- 6) propozon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;
- 7) propozon strategjinë e sigurisë nacionale dhe strategjinë e mbrojtjes;
- 8) vendos për njohjen e shteteve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore me shtetet e tjera;
- 9) propozon ambasadorët dhe shefat e përfaqësive të tjera diplomatike të jashtme të Malit të Zi;
- 10) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë ose me ligj.

Dispozitat me fuqi ligjore

Neni 101

Qeveria, gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, mund të miratojë urdhëresa me fuqi ligjore, nëse Kuvendi nuk ka mundësi që të mbledhet.

Qeveria është e obliguar që urdhëresat me fuqi ligjore t'ia paraqesë Kuvendit për verifikim menjëherë sa të ketë mundësinë Kuvendi që të takohet.

Përbërja e Qeverisë

Neni 102

Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, një apo më shumë zëvendëskryeministra dhe ministrat.

Kryeministri përfaqëson Qeverinë dhe kryeson punën e saj.

Zgjedhja

Neni 103

Presidenti i Malit të Zi propozon mandatarin në afatin prej 30 ditësh nga dita e konstituimit të Kuvendit.

Mandatarin për përbërjen e Qeverisë paraqet në Kuvend programin e vet dhe propozon përbërjen e Qeverisë.

Për programin e mandatarit dhe propozimin për përbërjen e Qeverisë, Kuvendi vendos njëkohësisht.

Papajtueshmëria e funksioneve

Neni 104

Kryeministri dhe anëtari i Qeverisë nuk mund të ushtrojë funksionin e deputetit dhe një funksion tjetër publik, as të ushtrojë profesionalisht një veprimtari tjetër.

Dorëheqja dhe shkarkimi

Neni 105

Qeveria dhe anëtari i Qeverisë mund të paraqesin dorëheqjen.

Dorëheqja e Kryeministrit konsiderohet dorëheqje e Qeverisë.

Kryeministri mund t'i propozojë Kuvendit që të shkarkojë një anëtar të Qeverisë.

Çështja e besimit

Neni 106

Qeveria mund të shtrojë në Kuvend çështjen e besimit të vet.

Çështja e mosbesimit

Neni 107

Kuvendi mund t'i votojë mosbesimin Qeverisë.

Propozimin për të votuar mbi mosbesimin e Qeverisë mund ta paraqesin së paku 27 deputetë.

Nëse Qeveria ka fituar votëbesimin, nënshkruarit e propozimit nuk mund të paraqesin propozim të ri mbi mosbesimin para përfundimit të afatit prej 90 ditësh.

Interpelanca

Neni 108

Interpelancën për të shqyrtuar çështje të caktuara lidhur me punën e Qeverisë mund ta paraqesin së paku 27 deputetë.

Interpelanca paraqitet në formë të shkruar dhe duhet të jetë e arsyetuar.

Qeveria i paraqet përgjigjen në afat prej 30 ditësh nga dita kur ka pranuar interpelancën.

Hetimi parlamentar

Neni 109

Kuvendi, me propozimin e së paku 27 deputetëve, mund të krijojë këshillin anketues me qëllim që të grumbullojë informacione dhe fakte mbi ngjarjet që kanë të bëjnë me punën e organeve shtetërore.

Pushimi i mandatit

Neni 110

Qeverisë i pushon mandati: me pushimin e mandatit të Kuvendit, me paraqitjen e dorëheqjes, me humbjen e besimit dhe nëse nuk e propozon buxhetin deri më 31 mars të vitit buxhetor.

Qeveria, të cilës i ka pushuar mandati, vazhdon punën deri në zgjedhjen e Qeverisë me përbërje të re.

Qeveria, të cilës i ka pushuar mandati, nuk mund të shpërndajë Kuvendin.

Administrata shtetërore

Neni 111

Punët e administratës shtetërore i kryejnë ministrinë dhe organet e tjera të administratës.

Kalimi dhe të besuarit e punëve

Neni 112

Disa punë të administratës shtetërore mund të kalohen me ligj në vetëqeverisjen lokale ose në një person tjetër juridik.

Disa punë të administratës shtetërore, me dispozitë të Qeverisë mund t'i besohen vetëqeverisjes lokale ose një personi tjetër juridik.

4. VETËQEVERISJA LOKALE

Mënyra e vendimmarrjes

Neni 113

Në vetëqeverisjen lokale vendoset drejtpërdrejt dhe përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

E drejta në vetëqeverisje lokale përfshin të drejtën e qytetarëve dhe organeve të vetëqeverisjes lokale që të rregullojnë dhe të administrojnë punë të caktuara dhe punë të tjera publike, në bazë të përgjegjësisë së vet dhe me interes për popullsinë lokale.

Forma e vetëqeverisjes lokale

Neni 114

Forma themelore e vetëqeverisjes lokale është komuna.

Mund të krijohen edhe forma të tjera të vetëqeverisjes lokale.

Komuna

Neni 115

Komuna ka cilësinë e personit juridik.
Komuna miraton statutin dhe aktet e përgjithshme.
Organet e komunës janë Kuvendi dhe kryetari.

Kompetencat pronësore dhe financimi

Neni 116

Komuna kryen kompetenca të caktuara pronësore mbi gjërat në pronësi shtetërore në pajtim me ligjin.

Komuna ka pronë.

Komuna financohet nga të ardhurat e veta dhe mjetet e shtetit.

Komuna ka buxhetin.

Pavarësia

Neni 117

Komuna është e pavarur në kryerjen e kompetencave të veta.

Qeveria mund të shpërndajë Kuvendin e komunës, gjegjësisht të shkarkojë kryetarin e komunës vetëm nëse Kuvendi i komunës, gjegjësisht kryetari i komunës, në afatin kohor më të gjatë se gjashtë muaj, nuk kryejnë detyrat brenda kompetencave të veta.

5. G J Y K A T A

Parimet e gjyqësisë

Neni 118

Gjykata është autonome dhe e pavarur.

Gjykata gjykon në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe kontratave ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara.

Ndalohet themelimi i gjykatave të parregullta dhe të jashtëzakonshme.

Kolegji gjyqësor

Neni 119

Gjykata gjykon në kolegji, përveç kur me ligj përcaktohet se gjykon gjyqtari individ.

Në gjykim marrin pjesë edhe gjyqtarët-anëtarë të jurisë, kur kjo është përcaktuar me ligj.

Gjykimi publik

Neni 120

Shqyrtimi para gjyqit është publik dhe vendimet e gjykimit shprehen publikisht.

Në raste të jashtëzakonshme, gjykata mund të përjashtojë publikun nga shqyrtimi ose nga një pjesë e tij, për arsye që janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike, vetëm në masën e duhur: në interes të moralit; rendit publik; kur gjykohen personat e mitur; me qëllim të mbrojtjes së jetës private të palës; në mosmarrëveshjet martesore; në

procedurat lidhur me përkujdesjen dhe adoptimin; me qëllim që të ruajë fshehtësinë ushtarake, afariste dhe zyrtare dhe ruajtjen e sigurisë dhe mbrojtjen e Malit të Zi.

Qëndrueshmëria e funksionit

Neni 121

Funksioni i gjyqtarit është i përhershëm.

Gjyqtarit i pushon funksioni nëse kërkon vetë, kur i përmbush kushtet për realizimin e të drejtës për pension pleqërie dhe nëse është dënuar me burgim të pakushtëzuar.

Gjyqtari shkarkohet nga detyra: nëse është dënuar për veprën që e bën të padenjë për kryerjen e funksionit të gjyqtarit; nëse kryen funksionin e gjyqtarit në mënyrë joprofesionale ose të pandërgjegjshme ose nëse e humb përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit.

Gjyqtari nuk mund të transferohet ose të dërgohet në një gjykatë tjetër kundër vullnetit të vet, përveç me vendimin e Këshillit Gjyqësor në rast të riorganizimit të gjyqeve.

Imuniteti në bazë të funksionit

Neni 122

Gjykatësi dhe gjykatësi-anëtar i jurisë gëzon imunitetin funksional.

Gjykatësi dhe gjykatësi-anëtar i jurisë nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e shprehur ose votimin gjatë marrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse bëhet fjalë për një veprë penale.

Gjykatësi, në procedurën e nisur për shkak të veprës penale të bërë gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor, nuk mund të arrestohet pa lejen e Këshillit Gjyqësor.

Papajtueshmëria e funksioneve

Neni 123

Gjyqtari nuk mund të ushtrojë funksionin e deputetit ose një funksion tjetër publik, as të ushtrojë profesionalisht një veprimtari tjetër.

Gjykata Supreme

Neni 124

Gjykata Supreme është gjykata më e lartë në Mal të Zi.

Gjykata Supreme siguron zbatimin e njëjtë të ligjeve nga ana e gjyqeve.

Kryetarin e Gjykatës Supreme e emëron dhe shkarkon nga ky funksion Kuvendi me propozim të përbashkët të Presidentit të Malit të Zi, kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit.

Nëse propozimi për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme nuk paraqitet në afatin prej 30 ditësh, kryetari i Gjykatës Supreme zgjidhet me propozimin e organit kompetent të Kuvendit.

Zgjedhja e gjykatësve

Neni 125

Gjykatësin dhe kryetarin e gjyqit e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli Gjyqësor.

Kryetari i gjykatës zgjidhet në afatin kohor prej pesë vjetësh.

Kryetari i gjykatës nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Gjyqësor.

Këshilli Gjyqësor

Neni 126

Këshilli Gjyqësor është organ autonom dhe i pavarur i cili siguron pavarësinë dhe autonominë e gjyqeve dhe gjyqtarëve.

Përbërja e Këshillit Gjyqësor

Neni 127

Këshilli gjyqësor ka kryetarin dhe nëntë anëtarë.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor është kryetari i Gjykatës Supreme .

Anëtarët e këshillit gjyqësor janë:

- 1) katër gjyqtarë që i zgjedh dhe i shkarkon Konferenca e Gjyqtarëve;
- 2) dy deputetë që i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi nga radhët e shumicës parlamentare dhe opozitës;
- 3) dy juristë me famë të cilët i zgjedh dhe i shkarkon Presidenti i Malit të Zi;
- 4) Ministri i drejtësisë;

Përbërjen e Këshillit Gjyqësor e shpall Presidenti i Malit të Zi.

Mandati i Këshillit Gjyqësor është katër vjet.

Kompetencat e Këshillit Gjyqësor

Neni 128

Këshilli Gjyqësor:

- 1) zgjedh dhe shkarkon gjyqtarin, kryetarin e gjykatës dhe gjyqtarin-anëtar i jurisë;
- 2) përcakton pushimin e funksionit gjyqësor;
- 3) përcakton numrin e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve-anëtarë jurie në gjyq;
- 4) shqyrton raportin e punës së gjyqit, aplikimet dhe ankesat në punën e gjykatës dhe merr qëndrime lidhur me ato;
- 5) vendos për imunitetin e gjyqtarëve;
- 6) i propozon Qeverisë shumën e mjeteve për punën e gjyqeve;
- 7) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Këshilli Gjyqësor vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

Në procedurat me përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve, ministri i drejtësisë nuk voton.

6. USHTRIA E MALIT TË ZI

Parimet

Neni 129

Ushtria mbron pavarësinë, sovranitetin dhe territorin shtetëror të Malit të Zi, në pajtim me parimet e të drejtës ndërkombëtare mbi përdorimin e forcës.

Ushtria është nën kontrollin demokratik dhe civil.

Pjesëtarët e Ushtrisë mund të jenë në përbërje të forcave ndërkombëtare.

7. KËSHILLI PËR MBROJTJEN DHE SIGURINË

Kompetencat

Neni 130

Këshilli për Mbrojtjen dhe Sigurinë:

- 1) miraton vendimet mbi komandën e Ushtrisë së Malit të Zi;
- 2) analizon dhe vlerëson situatën e sigurisë në Mal të Zi dhe sjell vendime për ndërmarrjen e masave adekuate;
- 3) vendos, avancoon dhe shkarkon oficerët e Ushtrisë;
- 4) i propozon Kuvendit shpalljen e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme;
- 5) propozon përdorimin e Ushtrisë në forcat ndërkombëtare;
- 6) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;

Përbërja

Neni 131

Këshillin e Mbrojtjes dhe të Sigurisë në Malin e Zi e përbëjnë: Presidenti i Malit të Zi, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri.

Presidenti i Malit të Zi është Kryetari i Këshillit të Mbrojtjes dhe të Sigurisë.

Shpallja e gjendjes së luftës

Neni 132

Gjendja e luftës shpallet kur ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për Malin e Zi, kur Mali i Zi është i sulmuar ose kur i është shpallur luftë.

Nëse Kuvendi nuk ka mundësi të mblidhet, vendimin për shpalljen e gjendjes së luftës e sjell Këshilli i Mbrojtjes dhe i Sigurisë dhe ia paraqet Kuvendit për ta verifikuar menjëherë sapo Kuvendi të mblidhet.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme

Neni 133

Gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet në territorin ose një pjesë të territorit të Malit të Zi në rast:

- 1) të fatkeqësive të mëdha natyrore;
- 2) aksidenteve dhe epidemive teknike-teknologjike dhe ekologjike;
- 3) prishjes së madhe të rendit dhe sigurisë publike;
- 4) rrezikimit ose tentimit të rrënimit të rendit kushtetues.

Nëse Kuvendi nuk ka mundësi të takohet, vendimin për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme e sjell Këshilli i Mbrojtjes dhe i Sigurisë dhe ia paraqet Kuvendit për ta verifikuar menjëherë sapo Kuvendi të mblidhet.

Gjendja e jashtëzakonshme zgjat deri në pushimin e rrethanave për shkak të të cilave është shpallur.

8. PROKURORIA SHTETËRORE

Statusi dhe kompetencat

Neni 134

Prokuroria e Shtetit është organ shtetëror unik dhe i pavarur që kryen punët e ndjekjes së kryerësve të veprave penale dhe veprave të tjera ndëshkuese të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare.

Emërimi dhe mandati

Neni 135

Punët e Prokurorisë Shtetërore i kryen Prokurori Shtetëror.

Prokurori Shtetëror ka një ose më shumë zëvendës.

Prokurorin e lartë shtetëror dhe prokurorët shtetërorë i emëron dhe i shkarkon Kuvendi.

Prokurori i Lartë Shtetëror dhe prokurorët shtetërorë emërohen në afatin kohor prej pesë vjetësh.

Këshilli i prokurorëve

Neni 136

Këshilli i prokurorëve siguron pavarësinë e Prokurorisë Shtetërore dhe të prokurorëve shtetërorë.

Këshillin e prokurorëve e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi.

Zgjedhja, mandati, kompetencat, organizimi dhe mënyra e punës së këshillit të prokurorëve rregullohen me ligj.

Imuniteti në bazë të funksionit

Neni 137

Prokurori Shtetëror dhe zëvendësi i prokurorit shtetëror gëzojnë imunitet në bazë të funksionit dhe nuk mund të vihen para përgjegjësisë për mendimin e dhënë ose vendimin e marrë gjatë kryerjes së funksionit të vet, përveç nëse bëhet fjalë për veprë penale.

Papajtueshmëria e funksionit

Neni 138

Prokurori Shtetëror dhe zëvendësi i prokurorit shtetëror nuk mund të ushtrojnë funksionin e deputetit ose një funksion tjetër publik dhe as të ushtrojnë profesionalisht një veprimtari tjetër.

PJESA E KATËRT RREGULLIMI EKONOMIK

Parimet

Neni 139

Rregullimi ekonomik bazohet në tregun e lirë dhe të hapur, lirinë e sipërmarrjes dhe konkurrencën, pavarësinë e subjekteve ekonomike dhe përgjegjësisë së tyre për obligimet e marra përsipër për transaksionet juridike, mbrojtjes dhe barazisë së të gjitha formave të pronësisë.

Hapësira ekonomike dhe barazia

Neni 140

Territori i Malit të Zi është hapësirë unike ekonomike.

Shteti inkurajon zhvillimin e barabartë ekonomik të të gjitha territoreve të saj.

Ndalohet prishja dhe kufizimi i konkurrencës së lirë dhe inkurajimi i pozitës së pabarabartë, të monopolit ose pozitës dominuese në treg.

Prona shtetërore

Neni 141

Gjërat në pronësi shtetërore i takojnë shtetit të Malit të Zi.

Detyrimet tatimore

Neni 142

Shteti financohet nga tatimet, taksat dhe të ardhura të tjera.
Çdokush është i obliguar të paguajë tatimet dhe taksat e tjera.
Tatimet dhe taksat e tjera mund të futen vetëm me ligj.

Banka Qendrore e Malit të Zi

Neni 143

Banka Qendrore e Malit të Zi është organizatë e pavarur, përgjegjëse për stabilitetin monetar dhe financiar dhe funksionimin e sistemit bankar.
Bankën Qendrore të Malit të Zi e menaxhon Këshilli i Bankës Qendrore.
Bankën Qendrore të Malit të Zi e drejton Guvernatori i Bankës Qendrore.

Institucioni shtetëror i revizionit

Neni 144

Institucioni shtetëror i revizionit i Malit të Zi është organ i pavarur dhe suprem i revizionit shtetëror.

Institucioni shtetëror i revizionit i Malit të Zi kryen revizionimin e ligjshmërisë dhe shkallën e suksesit të menaxhimit me pronën shtetërore dhe obligimet, buxhetet dhe të gjitha punët financiare të subjekteve të cilat burimet e financimit i kanë publike ose krijohen me shfrytëzimin e pronës shtetërore.

Institucioni shtetëror i revizionit i paraqet Kuvendit raportin vjetor.
Institucionin shtetëror të revizionit e drejton Senati.

PJESA E PESTË KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA

Pajtueshmëria e dispozitave juridike

Neni 145

Ligji duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe kontratat ndërkombëtare të ratifikuara, kurse akti tjetër duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

Publikimi dhe hyrja në fuqi e dispozitave

Neni 146

Ligji dhe aktet e tjera publikohen para se të hyjnë në fuqi, kurse hyjnë në fuqi më së afërmi ditën e tetë nga dita e publikimit.

Në situata të jashtëzakonshme, kur për këtë ekzistojnë arsyet e përcaktuara në procedurën e miratimit, ligji dhe akti tjetër mund të hyjë në fuqi më së afërmi me ditën e publikimit.

Ndalimi i efektit të prapaveprimit

Neni 147

Ligji dhe akti tjetër nuk mund të ketë prapaveprim.

Në situata të jashtëzakonshme, dispozitat e veçanta të ligjit, nëse këtë e kërkon interesi publik i përcaktuar në procedurën e miratimit të ligjit, mund të kenë efekt të prapaveprimit.

Dispozita e Ligjit Penal mund të ketë efekt të prapaveprimit vetëm nëse është më e butë për kryesin e veprës penale.

Ligjshmëria e akteve të veçanta

Neni 148

Akti i veçantë juridik duhet të jetë në pajtueshmëri me ligjin.

Aktet përfundimtare të veçanta juridike gëzojnë mbrojtje gjyqësore.

PJESA E GJASHTË GJYKATA KUSHTETUESE E MALIT TË ZI

Kompetencat

Neni 149

Gjykata Kushtetuese vendos:

- 1) mbi përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe kontratat ndërkombëtare të ratifikuara dhe publikuara;
- 2) mbi përputhshmërinë e akteve të tjera dhe akteve të përgjithshme me Kushtetutën dhe ligjin;
- 3) për ankesën kushtetuese për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike efektive;
- 4) se a e ka shkelur Kushtetutën Presidenti i Malit të Zi;
- 5) për konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore, në mes të organeve shtetërore dhe organeve të njëjësive të vetëqeverisjes lokale dhe në mes të organeve të vetëqeverisjes lokale;
- 6) mbi ndalimin e punës së një partie politike ose një organizate joqeveritare;
- 7) mbi mosmarrëveshjet elektorale dhe mosmarrëveshjet lidhur me referendumin, të cilat nuk janë në kompetencë të gjykatave të tjera;
- 8) mbi përputhshmërinë me Kushtetutën të masave dhe veprimeve të organeve shtetërore të ndërmarra gjatë kohës së gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme;
- 9) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Nëse gjatë procedurës për vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë dispozita ka pushuar të jetë në fuqi, e nuk janë mënjeluar pasojat e zbatimit të saj, Gjykata Kushtetuese përcakton se a ka qenë kjo dispozitë në përputhje me Kushtetutën, gjegjësisht me ligjin gjatë kohës që ka qenë në fuqi.

Gjykata Kushtetuese përcjell realizimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe e njofton Kuvendin për dukuritë e vëna re të pa kushtetutshmërisë dhe paligjshmërisë.

Fillimi i procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

Neni 150

Çdokush mund të japë iniciativën për të ngritur procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Procedurën para Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë mund ta fillojë gjykata, një organ tjetër shtetëror, organi i vetëqeverisjes lokale dhe pesë deputetë.

Gjykata Kushtetuese mund edhe vetë të fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Gjatë procedurës, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që të ndalohet ekzekutimi i një akti ose veprimi të veçantë, të cilët janë marrë në bazë të ligjit, një dispozite tjetër ose akti të përgjithshëm, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e të cilëve vlerësohet, nëse me ekzekutimin e tyre do të mund të vijë deri tek pasojat e dëmshme të pariparueshme.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

Neni 151

Gjykata Kushtetuese vendos me shumicën e votave të gjithë gjyqtarëve.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese publikohet.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm dhe ekzekutiv.

Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kur kjo është e nevojshme, e siguron Qeveria.

Shfuqizimi i vlefshmërisë së dispozitës

Neni 152

Kur Gjykata Kushtetuese konstaton se ligji nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe kontratat ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara, gjegjësisht që dispozita tjetër nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, ky ligj ose dispozitë tjetër pushon të jetë në fuqi me ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Ligji ose dispozita tjetër, gjegjësisht dispozita të veçanta të tyre, për të cilat me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar se nuk janë në përputhje me Kushtetutën ose ligjin, nuk mund të zbatohen në raportet që kanë dalë para publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nëse deri me këtë ditë nuk janë zgjedhur në mënyrë të plotfuqishme.

Përbërja dhe zgjedhja

Neni 153

Gjykata Kushtetuese ka shtatë gjyqtarë.

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet për kohën prej nëntë vjetësh.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve në kohën prej tre vjetësh.

Për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet personi që gëzon reputacionin e ekspertit të dalluar juridik, me së paku 15 vjet përvojë në profesion.

Kryetari dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ushtrojë funksionin e deputetit dhe ndonjë funksion tjetër publik, as të ushtrojë profesionalisht një veprimtari tjetër.

Pushimi i funksionit

Neni 154

Kryetarit dhe gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon funksioni para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur, nëse këtë e kërkon vetë, kur plotëson kushtet për pension pleqërie dhe nëse është dënuar me burgim të pakushtëzuar.

Kryetari dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese shkarkohet nga detyra, nëse është dënuar për veprën që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit, nëse e humb përherë aftësinë për ushtrimin e funksionit ose haptas shpalos bindjet e veta politike.

Fillimin e arsyeve për pushimin e funksionit ose për shkarkim e përcakton Gjykata Kushtetuese në mbledhje dhe për këtë e njofton Kuvendin.

Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që kryetari ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, kundër të cilit është ngritur procedura penale, të mos ushtrojë funksionin deri sa të zgjasë kjo procedurë.

PJESA E SHTATË NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Propozimi për ndryshimin e Kushtetutës Neni 155

Propozimin për ndryshimin e Kushtetutës mund ta paraqesin Presidenti i Malit të Zi, Qeveria dhe më së paku 25 deputetë.

Me propozimin për ndryshimin e Kushtetutës mund të propozohet ndryshimi ose plotësimi i dispozitave të veçanta të Kushtetutës ose miratimi e Kushtetutës së re.

Propozimi për ndryshimin e dispozitave të veçanta të Kushtetutës duhet të përmbajë shënimin dispozitave që kërkohen të ndryshohen dhe arsyetimi i tyre.

Propozimi për ndryshimin Kushtetutës miratohet në Kuvend, nëse për të votojnë dy të tretat e gjithë deputetëve.

Nëse propozimi për ndryshimin e Kushtetutës nuk është aprovuar, i njëjti propozim nuk mund të përsëritet para se të kalojë një vit nga dita kur është refuzuar propozimi.

Akti për ndryshimin e Kushtetutës Neni 156

Ndryshimi i dispozitave të veçanta të Kushtetutës bëhet me anë të amendamenteve.

Projektin e aktit për ndryshimin e Kushtetutës e përpilon organi kompetent i Kuvendit.

Projekt akti për ndryshimin e Kushtetutës miratohet në Kuvend, nëse për të votojnë dy të tretat e të gjithë deputetëve.

Projekt aktin e miratuar për ndryshimin e Kushtetutës Kuvendi e vë në shqyrtim publik i cili nuk mund të zgjasë më pak se një muaj.

Me përfundimin e shqyrtimit publik, organi kompetent i Kuvendit përcakton propozimin e aktit për ndryshimin e Kushtetutës.

Akti për ndryshimin e Kushtetutës miratohet në Kuvend, nëse për të votojnë dy të tretat e të gjithë deputetëve.

Ndryshimi i Kushtetutës nuk mund të bëhet gjatë kohës së gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme.

Vërtetimi në referendum Neni 157

Ndryshimi i neneve 1, 2, 3, 4, 12, 13, 15, 45 dhe 157 është definitiv, nëse në referendumin shtetëror për ndryshim deklarohen tri të pestat e të gjithë zgjedhësve.

PJESA E TETË
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Ligji kushtetues për zbatimin e Kushtetutës

Neni 158

Për zbatimin e Kushtetutës miratohet ligji kushtetues.
Ligjin kushtetues për zbatimin e Kushtetutës e miraton Kuvendi me shumicën e votave të gjithë deputetëve.
Ligji kushtetues shpallet dhe hyn në fuqi njëkohësisht me Kushtetutën.

SU-SK Numër 01-514/21
Podgoricë, 19 tetor 2007

KUVENDI KUSHTETUES I REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

KRYETARI
Ranko Krivokapiq

Në bazë të nenit 15, paragrafi 1 i Ligjit mbi procedurën për miratimin dhe shpalljen e Kushtetutës së re të Malit të Zi (“Gazeta zyrtare e RMZ”, numër 66/06), Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në mbledhjen e tretë të seancës së dytë të rregullt në vitin 2007, me datën 22 tetor 2007, miratoi

VENDIMIN PËR SHPALLJEN E KUSHTETUTËS SË MALIT TË ZI

Shpallet KUSHTETUTA E MALIT TË ZI, të cilën e ka miratuar Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në mbledhjen e tretë të seancës së dytë të rregullt të vitit 2007, me datën 19 tetor 2007.

SU-SK Numër 01-514/22
Podgoricë, 22 tetor 2007

KUVENDI KUSHTETUES I REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

**KRYETARI
Ranko Krivokapiq**